



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 427/ 2010

Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Iniciative Qytetare Krahu Politik (GIKN) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS) me seli në Prishtinë, për shkak të shpërndarjes së vizitkartave dhe broshurave, në seancën e panelit të mbajtur më 13.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REUZOHET** si e pabazuara ankesa e subjektit politik Iniciative Qytetare Krahu Politik (GIKN).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 11.12.2010, nga subjekti politik GIKN, me të cilën pretendohet se më datë 10.12.2010 në Çagllavic disa persona kanë shpërndarë vizitkarta dhe broshura të subjektit politik SLS në emër të subjektit politik NCPK i cili subjekt nuk merr pjesë në zgjedhje andaj konsiderohet shkelje, *Kodit i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

**Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:**

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkakut se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 427/2010 më datën 13.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**

